

U D H Ë Z I M
Nr.33, datë 8.5.2001

PËR REGJISTRIMIN E STUDENTËVE NË LISTAT E ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E
KUVENDIT 2001

Në mbështetje të nenit 61 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

U D H Ë Z O N :

Për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të datës 24.6.2001, të gjithë studentët me shkëputje nga puna (që nuk kanë vendbanimin e përhershëm të familjes së tyre në qytetin ku ka qendrën universiteti) që do të votojnë në konviktet e qendrës studentore ku kanë vendbanimin e përkohshëm (vendqëndrimin). Për realizimin e kësaj të drejte, të procedohet si vijon:

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, me drejtoritë e ndërmarrjeve të trajtimit të studentëve të rretheve përkatëse, për studentët, familjet e të cilëve nuk kanë vendbanimin e përhershëm në qytetin ku ka qendrën universiteti dhe që banojnë në konvikte apo banesa me qira etj. në qytet, brenda datës 20.5.2001 duhet të kenë kryer regjistrimin e të gjithë studentëve, sipas formularit bashkëlidhur, grupuar sipas godinave të banimit me 800-1000 studentë për çdo qendër votimi.

2. Në datën 20.5.2001 ora 10 00, formularët e plotësuar dhe firmosur nga kujdestari i godinës drejtori i qendrës studentore, kundrejt një procesverballi, ia dorëzon supervizorit të KQZ-së në prefekturën përkatëse.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi